

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
Drejtoria e Shoqerive Publike
Nr. 809 Prot.

Tirane, me 11.4 1996

U R D H E R
Nr.2/18date 26.10.1995

P E R
SHITJEN E AKSIONEVE TE SHOQERISE ANONIME

S.E.S.A SHKODER

Ne baze te nenit 4, paragrafi i dyte i ligjit Nr.7926, date 20.04.1995, me cilesine e aksionerit te vetem,

U r d h e r o j :

1. Te privatizohet nepermjet shitjes me aksione shoqeria anonime SESA SHKODER
2. Shitja e aksioneve te behet 30 %.
3. Shitja e aksioneve ne perputhje me piken 2 te ketij Urdheri te perfundoje brenda afateve ligjore ne fuqi.

MINISTRI

Dylber VRIONI

12672

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
Drejtoria e Shoqerive publike
Nr. 2809 Prot.

Tirane, me 11.7. 1996

K E R K E S E
PER
DEPOZITIMIN E AKTEVE TE SHOQERISE ANONIME
S.E.S.A SHKODER NE RREGJISTRIN TREGTAR

Shoqeria anonime S.E.S.A SHKODER eshte themeluar si e tille me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 12672


Me Urdherin Nr.2/18, date 26.10.1995, me cilesine e aksionerit te vetem kam urdheruar shitjen e aksioneve-30 %

Shitja e aksioneve eshte realizuar nga Agjensia Kombetare e Privatizimit dhe aksionet u kane kaluar aksionereve te rinj sipas dokumentacionit bashkengjitur kesaj kerkese.

Si ish aksioner i vetem i kesaj shoqerie po depozitoj ne rregjistrin tregtar per shoqerine e mesiperm keto akte :

1. Urdherin per transferimin e aksioneve nga shteti tek personat e trete.
- 2.. Lista e aksionereve qe u eshte transferuar aksioni ne baze te nenit 198 te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".

*be' depozituar
me 30-7-96
gjykatere
Ded. J. M. Dedi*



8.11.1999

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE PUBLIKE
DHE PRIVATIZIMIT
Drejtoria Juridike

U R D H E R

Nr. 262 date 9.11.1999

PER
TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TE SHOQERISE ANONIME "SESA"
SHKODER TEK SHOQERIA ANONIME "KORPORATA
ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE" TIRANE

Ne baze te nenit 2 te Ligjit nr.7926 date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" (ndryshuar me akte te tjera), me cilesine e zoteruesit te aksioneve ne shoqerite anonime "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare" Tirane dhe "Sesa" Shkoder, perkatesisht ne masen 100% dhe 70% dhe te nenit 11 te statutit te shoqerise anonime "Sesa" Shkoder,

U r d h e r o j :

1. Te transferohen te gjitha aksionet e zoteruara nga shteti ne shoqerine anonime "Sesa" Shkoder tek shoqeria anonime "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare".

2. Transferimi i aksioneve ne perputhje me piken 1 te ketij urdheri te perfundoje brenda dates _____.

MINISTRI

Ylli BECI





KONTRATE

PER SHITBLERJEN E AKTIVITETIT TE SH.A. "SESA" SHKODER

E lidhur sot me date 12/03/2008, ne Tirane ndermjet paleve;

1. Sh.a. "SESA Shkoder", person juridik shqiptar, me seli te shoqerise ne Shkoder, perfaqesuar nga Drejtori i shoqerise z.Nesti Kiri, qe ketu e me poshte do te quhet **Shitesi**.

dhe,

2. Shoqerise anonime "Korporata Elektroenergjetike Shqiptare", sh.a. KESH, person juridik shqiptar, me seli te shoqerise ne bllokun "Vasil Shanto", perfaqesuar nga Drejtori i Pergjithshem z. Gjergj Bojaxhi, qe ketu e me poshte do te quhet **Bleresi**.

Ndersa; Me VKM Nr. 27 date 16.01.2003, "Per miratimin e programit te veprimit per permiresimin e treguesve tekniko - financiare te KESH - sha, per vitet 2003 - 2005" (faqe 8, pika 3.2 [1]), eshte eshte parashikuar blerja e aktivitetit te shoqerive sh.a. "SESA Shkoder", sh.a. "Elektriku Elbasan" dhe sh.a. "Elektriku Vlore" (qe ketu e me poshte do ti referohemi si **kompanite pilot**) nga sh.a. KESH - i.

Ndersa; Me shkresen Nr. 2357/1 date 16.3.2001, Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit me cilesine e perfaqesuesit te pronarit shtet, ka miratuar blerjen e aktivitetit te kompanive pilot nga sh.a. KESH - i.

Ndersa; Kompania franceze "FIKADEX" ka bere vleresimin e aktivitetit te kompanive pilot.

Ndersa; Me vendimet e Keshillit Mbikqyres te sh.a. KESH - it, Nr.16 date 14.3.2003 dhe Nr.53 date 30.9.2003, eshte miratuar blerja e aktivitetit te sh.a. "SESA Shkoder" ne vleren 90 000 000 (nentedhjete milione) leke.

Ndersa; Me vendimin e Keshillit Mbikqyres te sh.a. "SESA Shkoder" date 08.05.2003, eshte miratuar shitja e aktivitetit te sh.a. "SESA Shkoder" sh.a. KESH - it ne vleren 90 000 000 (nentedhjete milione) leke.

Ndersa; Me vendimin Nr.2 date 24.12.2007 te Asamblese se Aksionereve te sh.a. "SESA Shkoder", eshte miratuar shitja e aktivitetit te sh.a. "SESA Shkoder" sh.a. KESH - it ne vleren 90 000 000 (nentedhjete milione) leke.

palet bien dakort sa vijon;

**Neni 1
Objekti**

Objekt i kesaj kontrate eshte shitja e aktivitetit te sh.a. "SESA Shkoder" tek sh.a. KESH - it ne kushtet e parashikuara ne kete kontrate.

**Neni 2
Aktiviteti**

Per qellim te kesaj kontrate me aktivitet do te perfshihet, por jo duke u kufizuar vetem ne te, sa me poshte;

- ✓ Asetet e luajtshme dhe te paluajtshme te sh.a. "SESA Shkoder".
- ✓ Inventaret si dhe cdo dokument tjetër qe ka ne administrim sh.a. "SESA Shkoder", apo qe ndodhet ne administrimin e nje pale te trete por qe i takon sh.a. "SESA Shkoder".
- ✓ Debite dhe kredite qe ka sh.a. "SESA Shkoder" ndaj te treteve (perfshi dhe sh.a. KESH - in).
- ✓ Faturat, kontratat dhe te drejtat e detyrimit qe ka ndaj konsumatoreve te saj sh.a. "SESA Shkoder".
- ✓ Numrat e telefonit, llogarite si dhe cdo percaktim tjetër i ketij lloji me te cilin sh.a. "SESA Shkoder" kryen veprimtarine e saj.
- ✓ Te gjitha lejet, licensat dhe autorizimet qe ka ne zoterim sh.a. "SESA Shkoder" per kryerje e aktivitetit te saj.
- ✓ Bilancet kontabile dhe cdo lloj dokumenti tjetër financiar apo teknik.
- ✓ Si dhe cdo e mire tjetër materiale apo jomateriale qe i takon sh.a. "SESA Shkoder".

**Neni 3
Cedimi i te drejtave dhe detyrimeve**

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, sh.a. "SESA Shkoder" i cedon sh.a. KESH - it te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe ka ndaj cdo pale te trete dhe qe jane te transferueshme sipas legjislacionit civil shqiptar ne momentin e hyrjes ne fuqi te kesaj kontrate.

**Neni 4
Cmimi dhe menyra e pageses se tij**

Cmimi qe do te paguaje sh.a. KESH - i per blerjen e aktivitetit te sh.a. "SESA Shkoder", eshte 90 000 000 (nentedhjete milione) leke.

Neni 5

Ky cmimi do te paguhet ne 4 (kater) keste, perkatesisht nga 22 500 000 (njezete e dy milione e peseqint mije) leke/kest, ne numrin e llogarise _____ ne banken _____.

Neni 6

Pas nenshkrimit te kontrates, sh.a. KESH - i do te paguaje:

- Kesti i pare do te paguhet brenda tremujorit te pare te vitit 2008.
- Kesti i dyte do te paguhet brenda tremujorit te dyte te vitit 2008.
- Kesti i trete do te paguhet brenda tremujorit te trete te vitit 2008.
- Kesti i katert do te paguhet brenda tremujorit te katert te vitit 2008.

**Neni 7
Kalimi i pronesise**

Me nenshkrimin e kesaj kontrate nga palet, pronesia e aktivitetit te sh.a. "SESA Shkoder" ne kushtet e parashikuara ne kete kontrate, kalon nga shitesi tek bleresi.

Sh.a. "SESA Shkoder" deklarone se nuk ka me asnje pretendim per asnje nga perberesit e aktiviteti te pershkruar nenin 2 te kesaj kontrate, por jo duke u kufizuar vetem ne to.

**Neni 8
Deklarimet e shitesit**

Shitesi deklarone se eshte pronar i ligjshem i te gjitha perberesve te aktivitetit te pershkruara ne nenin 2 te kesaj kontrate.

Ai deklarone se do te paguaje tatimet e taksat sipas ligjit per kete shitje te biznesit te tij.

**Neni 9
Deklarimet e bleresit**

Bleresi deklarone se eshte ne gjendje te permbushe ne kohe detyrimet sipas kontrates per pagimin e cmimit.

**Neni 10
Kontrata**

Kjo kontrate se bashku me anekset e saj do te perbejne Kontraten ndermjet paleve. Kjo zevendesone dhe mbivendos cdo lloj marreveshje apo komunikimi tjetër te meparshem ndermjet paleve.

**Neni 11
Lajmerimet**

Te gjitha lajmerimet per implementimin e kesaj kontrate duhet te jene ne forme te shkruar dhe duhet tu drejtohen personave sa me poshte;

Per shitesin;

Z.Nesti Kiri
Drejtor i sh.a."SESA Shkoder"
Adresa: Zona e Shperndarjes Elektrike
Shkoder

Per bleresin;

Z. Gjergj Bojaxhi
Drejtor i Pergjithshem i sh.a. KESH - it
Adresa: Blloku "Vasil Shanto"
Tirane

Neni 12

Palet do te lajmerojne me shkrim njera tjetren per cdo ndryshim te personave apo adresave te mesiperme.

**Neni 13
Ligji i aplikueshme**

Kjo kontrate eshte ndertuar dhe do te interpretohet sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

**Neni 14
Ndryshimet**

Cdo ndryshimi kesaj kontrate do te behet ne menyre te shkruar dhe me akt noterial.

**Neni 15
Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

Palet do ti zgjidhin me mirekuptim mosmarreveshjet e tyre. Ne rast te kundert kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjet do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

**Neni 16
Heqja dore**

Nese njera nga palet heq dore nga ndonje term apo kusht i kesaj kontrate ne cdo kohe, atehere kjo heqje dore do te jete efektive vetem per ate lloj ceshjte dhe ate lloj qellimi per te cilen eshte hequr dore. Nese njera nga palet deshton te ushtroje apo eshte ne vonese ne ushtrimin e ndonje prej te drejtave te saj sipas kesaj kontrate, atehere kjo pale ruan te drejten qe te ushtroje kete kusht apo te drejte ne te ardhmen.

**Neni 17
Parcialiteti**

Nese gjykata percakton se ndonje kusht i kesaj kontrate eshte i pavlefshem ne pjeseresisht apo teresisht, atehere cdo lloj pavlefshmerie do te kete efekt vetem lidhur me ate kusht dhe nuk do te sjelle si pasoje pavlefshmerine e ndonje kushti tjetër te kontrates, dhe ky kusht i kontrates (i shpallur i pavlefshem) mund te ndryshohet, amendohet ose kufizohet ne masen qe te behet i vlefshem dhe te kete efekt.

Neni 18

Kjo kontrate nenshkruhet ne 3 (tre) kopje, 1 per shitesin, 1 per bleresin dhe nje qendron tek noteri.

SHITESI

SESA sh.a.
perfaqesuar nga
Drejtori i Pergjithshem
Nesti Kiri

BLERESI

KESH sh.a.
perfaqesuar nga
Drejtori i Pergjithshem
Gjergj Bojaxhi

NOTERI

NOTERE
BLERIN AVRAZI